



Pranuar / Datedum Received/Prizato Received/Received	14.01.2022	2	vetë grad Votat
Organ / Agjencia Organ / Agjencia Org / Agjencia	Tir. Prot. Tir. Prot. Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPSHIK	173/2022		1/3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1002/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Malësore Bajraktari Gashi, anëtarë, me Ilire Mehmeti-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1002/2021 të datës 03.12.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë Prishtinë, kundër organit të punësimit, Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 14.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejueshme ankesa A.nr.1002/2021 e datës 03.12.2021, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja Udhëheqëse e Divizionit për Menaxhimin e Resurseve Ujore, në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (me tej MMPHI), me datë 03.12.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5795/2021 të regjistruar me numër A.nr.1002/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 5476/21 të datës 02.12.2021 dhe Vendimit me numër protokolli 3358 të datës 19.04.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 22.12.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërsa Këshilli me datë 15.12.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5795/2021 të regjistruar me numër A.nr.1002/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 03.12.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të

datës 08.12.2021; Vendimin me numër protokoll 5467/21 të datës 02.12.2021; Vendimin me numër protokoll 3358 të datës 19.04.2021; Përgjigjen në ankesë të datës 15.12.2021; Shkresën shtojca1 Skema Organizative e ARPL-së; Dëshminë lidhur me përvojën e punës; Akt Emërimit të datës 01.07.2015; Vërtetimin e datës 27.10.2015; Vërtetimin e datës 31.08.2018; E-mail nga N.A. për H.K. të datës 14.12.2021; E-mail nga M.D. për N.A. i datës 14.12.2021; E-mail nga I.B. për H.K. i datës 14.12.2021; E-mail nga I.B. për M.G. i datës 01.12.2021; E-mail nga I.B. për H.K. i datës 08.12.2021; E-mail nga H.K. për I.B. i datës 06.12.2021; E-mail nga F.B. për N.A. i datës 02.12.2021; E-mail nga M.G. për I.B. i datës 22.09.2021; E-mail nga M.D. për I.B. i datës 20.09.2021; E-mail nga I.B. për N.A. i datës 23.09.2021; E-mail nga M.D. për I.B. i datës 20.09.2021; E-mail nga F.K. për M.D. i datës 21.05.2021; E-mail nga N.A. për H.K. i datës 12.12.2021; E-mail nga M.D. për I.B. i datës 08.06.2021; E-mail nga N.A. për H.K. i datës 12.12.2021; E-mail nga M.D. për I.B. i datës 30.07.2021; E-mail nga N.A. për H.K. i datës 12.12.2021; E-mail nga M.D. për I.B. i datës 29.06.2021; E-mail nga M.D. për I.B. i datës 24.05.2021; Kërkesa për Pushim e datës 30.11.2021; Kërkesa për Pushim e datës 09.11.2021; E-mail nga M.D. për I.B. i datës 22.11.2021; Kërkesën për Pushim e datës 15.11.2021; Raportin Mjekësor i datës 18.10.2021; Kërkesën për Pushim e datës 15.09.2021; Kërkesën për bartjen e pushimit vjetor i datës 04.06.2021; Kërkesën për Pushime të datës 27.07.2021; Kërkesën për kompensim të orëve shtesë jashtë orarit të punës me ditë pushimi i datës 30.07.2021; Kërkesën për Pushim e datës 06.07.2021; Raportin Mjekësor i datës 08.06.2021; E-mail nga I.B. për M.D. i datës 16.11.2021; Vendimin me numër protokoll 1965/21 i datës 25.05.2021; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit i datës 11.07.2021;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesa pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses është e palejuar, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës, përkatësisht sipas Ndryshim dhe Plotësim Aktit të Emërimit të datës 11.07.2017, është konstatuar se ankuesja është e emëruar në pozitën e punës Udhëheqëse e Divizionit për Menaxhimin e Resurseve Ujore, në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, tani Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës(tutje MMPHI).

Ankuesja me Vendimin me numër protokoll 1965/21 të datës 25.05.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, është caktuar Zëvendësuese e Drejtorit të Departamentit të Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore, për periudhe prej gjashtë (6) mujore, respektivisht deri me 25.11.2021.

Pas skadimit të periudhës kohore sipas Vendimit me numër protokoll 1965/21 të datës 25.05.2021, Sekretari i Përgjithshëm i MMPHI përmes emailit zyrtar të datës 01.12.2021, ka kërkuar nga Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit të Resurseve Ujore që të pranoj detyrën e Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit të Autoritet Rajonal të Pellgjeve Lumore (me tej DARPL), duke shtuar se ankueses në pozitë të Udhëheqëses për Menaxhimin e Resurseve Ujore nuk mund ti vazhdohet vendimi për zëvendësim të Drejtorit të DARPL-së, për shkak se e njëjta kishte probleme shëndetësore dhe mungesa në punë, dhe për këto arsye nuk ka treguar ndonjë rezultat në menaxhimin e detyrës në fjalë. me datë 01.12.2021 ka njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm, se nuk mund të pranoj kërkesën për Zëvendësues të Drejtorit të DARPL-së, me arsyetimin se në vitin pasues do të pensionohet dhe se është e angazhuar në disa projekte të rëndësishme.

Sekretari i Përgjithshëm i MMPHI-së, me Vendimin me numër 5467/21 të datës 02.12.2021 ka caktuar zëvendësues të Drejtorit të DARPL-së, i cili sipas Vendimit me numër



protokoll 3358 të datës 19.04.2021 ushtronte detyrën e zëvendësuesit të Udhëheqësit të Divizionit për Pagesa dhe Projekte.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon së Vendimi me numër protokoll 5476/21 i datës 02.12.2021 dhe Vendimi me numër protokoll 3358/21 i datës 19.04.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, janë nxjerrë me shkelje thelbësore si dhe shkelje të ligjit material, duke kërkuar që Këshilli ti anuloi këto vendime dhe të obligoj Sekretarin e Përgjithshëm të MMPHI, që ta kthej në vendin e punës Zyrtar i Lartë i Pasurisë me obligimin që i njëjti t'i kthej mjetet e paguara shtesë për pozitat e zëvendësuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike, konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke ju referuar nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...", Kolegji vlerëson se me vendimet e kundërshtuara me ankesë, nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankueses lidhur me marrëdhënien e saj të punës, fakt ky që nuk është pretenduar as nga ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill, kështu që, bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nenparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhë se ankesa A.nr.1002/2021 e datës 03.12.2021, e parashtruar nga ankuesja është e papranueshme.

Bazuar në të gjeturat si me lartë, Kolegji pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1002/2021

**Ilire Mehmeti**

Procesmbajtës

**Ardita Haxhnikaj DEMI**

Kryetarja e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet**

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm në MMPHI;
- Udhëheqësit të Personelit në MMPHI; dhe
- Arkivot të KPMSHC-së.